



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-064

Prishtinë, më 11 prill 2019, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 11 PRILL 2019**

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit dhe Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Ahmet Isufi, Dardan Sejdiu, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Blerand Stavileci, Valmir Klaiqi dhe Gazmend Krasniqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

**Nga EUSR-ja:** Blerta Bejtullahu dhe

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Kërkesa e 41 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme.

\* \* \*

### **1. Kërkesa e 41 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme**

Kryetari i Kuvendit i njoftoi të pranishmit se 41 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 38, pika 2c të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, më 11 prill 2019, për debat parlamentar lidhur me zbrazjen e vendit nga të rinjtë, si rreziku më i madh që i kanoset vendit që nga paslufta.

Lidhur me kërkesën e 41 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit; Bilall Sherifi, kryetar i GP të Nismës Socialdemokrate; Memli Krasniqi, kryetar i GP të PDK-së dhe Avdullah Hoti, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet sot, e enjte, më 11 prill 2019, menjëherë pas përfundimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, me këtë:

### **Rend dite**

*1. Debat parlamentar lidhur me zbrazjen e vendit nga të rinjtë, si rreziku më i madh që i kanoset vendit që nga paslufta.*

Kryesia, po ashtu vendosi që vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara, e cila ishte caktuar të mbahet sot, më 11 prill 2019, në orën 10:00, shtyhet për të hënë, më 15 prill 2019, në orën 10:00.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit:  
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*